

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-047/14

Prishtinë,
11 Nëntor 2015

Në çështjen juridike të:

Xh.G.

Rr. Halil Agusholli 110

Pejë

Pala ankuese

Kundër

V.D.

Mali i Zi

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Anders Cedhagen gjyqtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/190/2013 (lënda është regjistruar në AKP me numër KPA28991), të datës 13 Shkurt 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 11 Nëntor 2015 , mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e Xh.G. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/190/2013 të datës 13 shkurt 2013 për sa i përket kërkesës së regjistruar në AKP me numrin 28991.

2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/190/2013 i datës 13 shkurt 2013, për sa i takon kërkesës së regjistruar në AKP me numrin 28991.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 19 shtator 2007, V.D. (në tekstin e mëtejme: paraqitësja e kërkesës), ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP) ku ka kërkuar ri-posedimin e pronës së saj. Ajo ka pohuar se është bashkëpronare e një ngastre që ndodhet në Komunën e Pejës, ngastra numër 128/1, me sipërfaqe prej 00.04.02 ha (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar) dhe ka deklaruar se prona ishte e uzurpuar. Paraqitësja e kërkesës pohon se prona e paluajtshme ishte humbur si rezultat i rrethanave të vitit 98/99 në Kosovë dhe thekson se data e humbjes është 12 qershor 1999.
2. Për të mbështetur kërkesën e saj paraqitësja e kërkesës, ka dorëzuar në AKP provat vijuese:
 - Kontratën e Shitblerjes e lidhur me 6 nëntor 1991 mes V.V. në cilësinë e shitësit të ngastrës nr. 4940/1 dhe S.G. në cilësinë e blerësit. Kontrata nuk përmban pronën e kërkuar si dhe nuk është e legalizuar në gjykatën kompetente.
 - Fletën Poseduese nr. 937 të lëshuar nga Departamenti për Kadastër dhe Gjeodezi të Republikës së Serbisë me datën 17 shkurt 1997. Bazuar në fletën poseduese, V.V. është bashkëpronarë (1/5 pjesë ideale) i pronës së kërkuar.
 - Aktvendimin e trashëgimisë Nr.Vr. 20/97 lëshuar nga Gjykata Komunale e Pejës me datën 17 shkurt 1997 me të cilën V.D. ka trashëguar 1/3 të pjesës ideale të pronës së kërkuar nga babai i saj i ndjerë V.V..

- Certifikatën e Vdekjes nr. 200-3/000SI/97 lëshuar nga Zyra për Regjistrin Civil të Komunës së Pejës me datën 17 shkurt 1997 ku dëshmohet se V.V.kishte vdekur me datën 11 Shkurt 1997 në Komunën e Pejës.
 - Deklaratën me shkrim nga paraqitësja e kërkesës e datës 16 shtator 2009 me të cilën ajo deklaroi se babai i saj i ndjerë V.V.i kishte shitur vetëm ngastrën nr. 4940/1 me sipërfaqe prej 00.23.44 ha të ndjerit S.G.(babait të Xh.G.).
3. Më 8 nëntor 2008, AKP-ja ka bërë identifikim e pronës e cila u gjet të jetë shtëpi e shkatërruar dhe e pa okupuar. Konfirmimi dhe identifikimi i pronës ishte dhe është bërë me datën 16 Shkurt 2010.
 4. Më 25 tetor 2011, Xh.G. (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në kërkesë) si trashëgimtare e bashkëshortit të saj të ndjerë, përmes avokatit B.L. , merr pjesë në procedurën para AKP-së, duke mohuar pretendimet e paraqitëses së kërkesës dhe duke shprehur interes ligjor për pronën që është objekt i kërkesës.
 5. Për të mbështetur pretendimin e saj ajo ka dorëzuar në AKP mes tjerash këto dëshmi :
 - Kontratën e Shitblerjes e lidhur me 6 nëntor 1991 mes V.V.në cilësinë e shitësit të ngastrës nr. 4940/1 dhe S.G.në cilësinë e blerësit të pronës. Kontrata nuk është e legalizuar.
 - Deklaratën me shkrim të datës 17 korrik 2008 ku M.L. deklaroi se V.V. i ka shitur pronë të paluajtshme (nuk ka informatë në lidhje me sipërfaqen) I.G. në vitin 1991.
 - Deklaratën me shkrim të datës 28 korrik 2008 ku Xh.G. pohon se babai tij , S.G.në vitin 1992 kishte blerë pronë të paluajtshme (me sipërfaqe prej 00.25.00 ha) nga V.V. dhe kontrata e shitblerjes ishte përpiluar në zyrën e avokatit B.L. .
 - Deklaratën me shkrim të datës 28 korrik 2008 ku E.G. deklaroi se S.G. kishte blerë pronë (me sipërfaqe prej 00.25.00 ha) nga V.V. . E.G. pretendon gjatë përpilimit të kontratës në zyrën e avokatit ishin prezent ai dhe i biri i S.G. (Xh.G.).
 - Padinë C. Nr. 525/09 për konfirmimin e të drejtës pronësore në bazë të kontratës së shitblerjes e dorëzuar në Gjykatën Komunale të Pejës me datën 18 gusht 2009 nga XH., D.,D.,D.,D.,D.,D., G. (Paditësit-të gjithë të përfaqësuar nga avokati B.L.) kundër V.D. , O.S., D.T., L.V, M.V., N.V. (të Paditurit).
 - Copja e Planit e lëshuar më 1 korrik 2010 nga Departamenti për Kadastër i Komunës së Pejës. Prona e kërkuar figuron të jetë në emër të 7 (shtatë) bashkëpronarëve e ndërta edhe V.D.

- Shkresa e avokatit B.L. dorëzuar në AKP me datën 20 tetor 2011 në bazë të cilës avokati thekson se Xh.G. ka vdekur ne vitin 2008 kurse si trashëgimtarë ka lënë Xh.G. (bashkëshorte) dhe fëmijët (D.,D., D., D., D., D. G.). B.L. pretendon se babai i të ndjerit Xh.G. (S.G.) kishte blerë ngastrat nr.4940/2, 4940/3 dhe 130/2 nga V.V.ku edhe kanë ndërtuar shtëpinë. (sipas tij shtëpia ishte ndërtuar në ngastrën nr. 4940/3).
6. Sipas raporteve të verifikimit të AKP-së, Aktvendimi i trashëgimisë T. Nr. 20/97 është verifikuar pozitivisht. Gjithashtu, fleta poseduese Nr. 937 e siguruar *ex officio* nga AKP me datën 30 dhjetor 2008 e azhurnuar në emër të shtatë bashkëpronarëve e ndër ta edhe V.D. .
 7. Më 19 prill 2012, Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKKPK-ja) urdhëroi mbajtjen e seancës dëgjimore nga një prej anëtarëve të tij, (bazuar në nenin 5.4 të aneksit III të urdhëresës administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me ligjin Nr. 03/L-079) në mënyrë që të sigurojë disa informata shtesë lidhur me kërkesën. Të ftuar në seancën dëgjimore ishin paraqitësja e kërkesës, pala përgjegjëse në kërkesë si dhe N.B, Sh.M., H.L. në cilësinë e dëshmitarëve. Megjithatë vetëm pala përgjegjëse dhe dëshmitarët erdhën në seancë. Paraqitësja e kërkesës nuk morri pjesë dhe mospjesëmarrjen e saj nuk e arsyetoi.
 8. Gjatë seancës dëgjimore të mbajtur me datën 24 maj 2012, pala përgjegjëse në kërkesë bashkë me dëshmitarët konfirmuan deklaratat e tyre të mëparshme duke ri theksuar se Xh.G. kishte blerë paluajtshmëri me sipërfaqe deri 00.24.00 ha nga V.V. në vitin 1991 kurse ne vitin 1992 kishte ndërtuar shtëpinë në të cilën jetojnë edhe tani, mirëpo prona e kërkuar (ngastra 128/1) nga paraqitësja e kërkesës nuk përmendet në asnjë rast.
 9. Pas seancës dëgjimore, KKKPK-ja më 13 shkurt 2013, me vendimin e vet KPCC/D/R/190/2013 vendos se paraqitja e kërkesës është pronare e 1/15 të pronës së kërkuar dhe gjithashtu ishte pronare në ditën e shkatërrimit të pronës së kërkuar dhe të tokës në të cilën gjendej ajo. Në paragrafët 19-23 të vendimit grupor, që sipas vendimit të vërtetuar të datës 13 shkurt 2013, zbatohet veçanërisht për kërkesën në fjalë, theksohet se paraqitësja e kërkesës mbështeti kërkesën e saj në një vendim trashëgimie të vitit 1997 në bazë të cilit ajo ka trashëguar pronën e kërkuar nga babai i saj. Vendimi i trashëgimisë është verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive dhe për më tepër është gjetur *ex officio* fleta poseduese e vitit 2008 që tregon paraqitësen e kërkesës si bashkëpronare të pronës së kërkuar. Pala përgjegjëse pretendon se bashkëshorti i saj e kishte blerë pronën e kërkuar në vitin 1991 nga babai i paraqitëses së kërkesës dhe kishte ndërtuar shtëpi mbi të. Në mbështetje të pohimit të saj, ajo ka paraqitur një sërë deklaratash të palëve të treta të cilët pretendojnë se kanë qenë dëshmitar të transaksionit pronësor që lidhet me një ngastër prej 25 ari, mes babait të paraqitëses së kërkesës dhe bashkëshortit të palës përgjegjëse. Në seancën dëgjimore që u mbajt me datën 24 maj 2012, pala përgjegjëse përsëriti pretendimet e saj të mëparshme se në vitin 1991, bashkëshorti i saj i ndjerë

e kishte blerë një ngastër nga babai i paraqitëses së kërkesës e cila përbehet prej 24 ari dhe se kishte paguar çmimin e blerjes prej 3.700 DM. Të tri dëshmitaret, konfirmuan se bashkëshorti i palës përgjegjëse e kishte blerë tokën nga babai i paraqitëses së kërkesës dhe një nga dëshmitarët deklaroi se ai ishte i pranishëm kur ishte lidhur kontrata e kur ishin paguar të hollat. Komisioni vëren se dëshmitë nuk lidhen me pronën e kërkuar por me pronën e cila ka qenë objekt i kontratës së vitit 1991. Kështu, bazuar në dëshmitë para tij dhe në mungesë të mbrojtjes së vlefshme nga pala përgjegjëse, Komisioni arrin në përfundim se kërkesa duhet të miratohet në emër të paraqitëses së kërkesës.

10. Më 13 mars 2014, vendimi i është dorëzuar V.D. . Paraqitësja e kërkesës (në tekstin e mëtutjeshëm: pala përgjegjëse në ankesë nuk kishte reaguar .
11. Xh.G. (në tekstin e mëtutjeshëm: pala ankuese) ka pranuar vendimin me datën 1 nëntor 2013 dhe ajo ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme me datën 2 dhjetor 2013.
12. Pala përgjegjëse në ankesë e kishte pranuar ankesën me datën 13 Mars 2014 por nuk ishte përgjigjur në ankesë.

Pretendimet e palës ankuese

13. Xh.G. pretendon se vendimi i KKPK së përmban shkelje esenciale të drejtës materiale dhe procedurale pasi i njëjti mbështetet në provat e njëanshme ndërsa nuk ka marrë në konsideratë provat dhe deklaratat e paraqitura nga pala përgjegjëse në kërkesë (tani pala ankuese).
14. Pala ankuese bashkëngjiti në ankesë dokumentet në vijim :
 - Deklarata me shkrim e datës 26 nëntor 2013 në të cilën M.L. deklaroi se në muajin Nëntor 1991 V.V.i kishte shitur S.G. një paluajtshmëri me sipërfaqe 23 apo 24 ari. Në vitin 1992 Xh.G. kishte blerë nga V.V.edhe dy ngastra tjera(nuk i di numrat e ngastrave) me sipërfaqe prej 21 dhe 7 ari me çmim total 4.000 DM. Ai thekson se ishte i pranishëm kur Xh.G. i pagoi çmimin e blerjes V.V..
 - Deklaratë me shkrim Nr. 4413/13 të datës 29 nëntor 2013 ku I.G. thekson se në vitin 1991 S.G.kishte blerë nga V.V.një ngastër me sipërfaqe prej 23 ari. Më vonë diku në vitin 1992 Xh.G. ka blerë edhe dy pjesë tjera (numrat e ngastrave nuk i di) me sipërfaqe prej 21 ari si dhe një ngastër tjetër prej 7 ari me çmimin 4.000 DM.
 - Certifikata e Vdekjes nr. 252 lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Komunën e Pejës me datën 8 korrik 2013 ku provohet se Xh.G. kishte vdekur me datën 14 Shtator 2008.

- Fatura e rrymës e datës 4 nëntor 2013.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

15. Gjykata Supreme e Kosovës vendimin ankimor e shqyrtoi në pajtim me dispozitat e nenit 194 të LPK së, dhe pas vlerësimit të thënieve ankimore gjeti se:
16. Ankesa është e pranueshme ngase është paraqitur brenda afatit ligjor sipas nenit 12.1 të rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 ,ku parashikohet që pala mund të paraqesë ankesë kundër vendimit të Komisionit brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve për vendimin.
17. Vendim i është dorëzuar palës ankuese më 1 nëntor (e enjte) 2013. Afati për paraqitjen e ankesës ishte 1 dhjetor (e diell). Neni 7.2 i Urdhëresës Administrative 2007/5 (Aneksi i Ligjit Nr.03/L-079 dhe neni 126.5 i LPK-së parashohin: *Kur dita e fundit e një afati bie në ditë feste shtetërore apo ditën e diel ose në ndonjë ditë tjetër kur nuk punon gjykata, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit.* Ankesa është paraqitur nga pala ankuese më 2 dhjetor (e hëne) 2013. Rrjedhimisht, konsiderohet se ankesa është paraqitur brenda afatit ligjor

Meritat e ankesës

18. Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palës ankuese, Gjykata Supreme ka vërejtur se ankesa është e pabazuar. Vendimi i KKPK-së është i drejtë. Gjykata nuk gjen as vërtetimin jo të plotë të fakteve e as zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale.
19. Sipas nenit 3.1 Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhëresë nga Komisioni për ri-posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që dëshmon pronësinë e pronës së paluajtshme private, por edhe që ai nuk është në gjendje aktualisht t'i ushtrojë këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave

që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. Pasi që paraqitësi i kërkesës cek se data e humbjes është qershori i vitit 1999, kërkesa ka të bëjë me rrethanat që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me apo rezultojnë nga konflikti i armatosur në Kosovë.

20. Gjykata Supreme pajtohet me AKP-në se pala përgjegjëse në kërkesë/pala ankuese, përderisa pretendon të drejtën e saj ligjore ndaj pronës, nuk ka paraqitur dokumentacion apo ndonjë informacion tjetër në mbështetje të asaj të drejte as në kohën e njoftimit të pronës e as në ankesë, përkundër faktit se asaj i është dhënë mundësia për ta bërë këtë. Në ankesë, pala ankuese deklaroi se bashkëshorti i saj është pronar i disa ngastrave nr. 4940/2, nr. 4940/3 nr. 130/2. Këto ngastra nuk kanë të bëjnë asgjë me vetë kërkesën, e cila i referohet ngastrës nr. 128/1. Pala ankuese i referohet një kontrate të shitblerjes të vitit 1991 e që objekt shitblerjeje ka një ngastër tjetër (ngastra nr. 4940/1).
21. Gjykata Supreme vëren se pala ankuese ka bashkangjitur në ankesë evidenca të reja (deklarata të dëshmitarëve).
22. Bazuar në nenin 12.11 të ligjit 03/L-079 për ndryshimin e rregullores së UNMIK ut 2006/50 , faktet e reja dhe dëshmitë materiale të paraqitura nga cilado palë lidhur m ankesën nuk pranohen dhe nuk shqyrtohen nga Gjykata Supreme përpos nëse tregohet se faktet dhe dëshmitë e tilla me arsye nuk kanë mundur të jenë të njohura për palën në fjalë. Pasi që pretendimet e njëjta nga palët e njëjta ishin përmendur para AKP/KPCC the evidencat e prezantuara nga pala ankuese nuk janë të reja.
23. Për më tepër, Gjykata konstatoi se deklaratat e përmendura më lart përmbajnë të njëjtat pretendime si deklaratat që janë vlerësuar nga KKPK-ja dhe të njëjtat janë konsideruar si të pamjaftueshme për të refuzuar kërkesën e palës përgjegjëse në ankesë. Prona e kërkuar, ngastra 128/1 nuk përmendet në asnjë kontratë e blerjes në mes të babait palës përgjegjëse në ankesë dhe bashkëshortit të palës ankuese.
24. Për më tepër Gjykata konstaton se të njëjtat deklarata nuk ishin relevante dhe nuk do të kishin asnjë efekt në vendim marrje.
25. Nga faktet e lartpërmendura rezulton se gjendja faktike në këtë çështje juridike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë dhe se konfirmimi i vendimit të KKPK-së nuk është sjellë në dyshim nga asnjë provë e vlefshme.
26. Në bazë të lartcekurave dhe në lidhje me nenin 13.3 (c) të Ligjit nr. 03/L-079 , Gjykata vendosi si në dispozitiv.

Këshillë ligjore

27. Sipas nenit 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo atyre të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini , Kryetar i Kolegjit

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Anders Cedhagen , Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufet, Referent i EULEX-it